

- a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- e) të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- g) nivelin e punësimit në veprimtari
- h) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- i) adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

7. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në plan biznes;
- b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- d) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin ofertë për dhënie në përdorim, dhe i dorëzohet komisionit të posaçëm të vlerësimit të dokumentacionit, në orën e hapjes së vlerësimit të ofertave.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

8. Vendi i zhvillimit të konkurimit:(Adresa:) Drejtoria Juridike Bashkia Ura Vajgurore.

9. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: me date 19.04.2021, ora 10.00

10. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit/konkurimit mund të trerhiqen pranë autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

|         |         |      |       |                          |
|---------|---------|------|-------|--------------------------|
|         | Po      | X    | Jo    | <input type="checkbox"/> |
| Nëse Po | Monedha | leke | Çmimi | 1500                     |

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit .

## **BASHKIA KRUJË**

NJOFTIM

Për zhvillimin e procedurës së konkurimit për dhënien me qira të ekonomisë pyjore Kraste- Kruje në ngastraen pyjore me nr. 22/a me sipërfaqe 3.8 ha, pronë e bashkisë Krujë me afat përdorimi 10 vjeçar .

1. Fillimi i procedurave për dhënien me qira të ekonomisë pyjore Kraste- Kruje në në ngastraen pyjore me me nr. 22/a me sipërfaqe 3.8 ha, pronë e bashkisë Krujë me afat perdorimi 10 vjecar .
1. Qellimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm të sipërfaqes pyjore të përcaktuar në pikën 1, për mbareshtimin e flores se eger dhe kultivimin bimeve te ndryshme, me sipërfaqen totale prej 3.8 ha, pronë e bashkisë Krujë me afat perdorimi 10 vjecar , me çmimin dysHEME 76.000( shtatedhjetë e gjashtë mijë )lekë,e përlllogaritur kjo sipas VKM-se nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.10.2010, lidhja 5 “Tarifat dysHEME për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta”
2. Afati i dhënies me qira do të jetë 10 vite.
3. Pikët vlerësuese do të jenë :
  - projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin Fletorja Zyrtare PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 30 pikë
  - planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë
  - masën e qirasë për kv /lek/vit 45 pikë
4. Terheqja e dokumentacionit te nevojshem do te behet ne zyren e caktuar nga bashkia per pyjet dhe kullotat.
5. Dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët për marrjen me qira do të jetë si më poshtë:
  - kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet.
  - ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
  - projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar.
  - planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.
  - çmimin e qirasë së ofruar për kv/lek/vit;
  - adresën e subjektit, telefon, email dhe faks.
  - vertetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor që nuk është në proces gjyqësor që lidhet me aktivitetin.
  - vertetim nga Prokuroria e rrethit gjyqësor që nuk është në ndjekje penale
  - licencë QKL e noterizuar
  - çertifikatë regjistrimi (NIPT) e noterizuar
  - deklarin e kerkuesit që ka stafin dhe të gjitha poajisjet për veprimtarinë që do të ushtroje.
  - garanci bankare.
6. Paraqitja e dokumentacionit do te kryhet prane Bashkise Krujë,Zyra e Njësise së Prokurimeve, me datë 23.04.2021, ora 10-00.